



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 220 Prot.

Gjirokastrë, më 11 02 /2020

Lënda: Dërgohen projekt – propozimet për aplikim për programe të reja studimi .

Znj. BESA SHAHINI

MINISTËR

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 14 pika 6 dhe pika 9, vendimit nr. 879 datë, 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë " dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " Kreu IV dhe Kreu VI pika 4 dhe 5 , po ju përcejllim projekt – propozimet për aplikim për programe të reja studimi që do të ofrohen nga universiteti ynë bashkangjitur kësaj shkrese.

Gjithashtu po ju dërgojmë, Vendimin e Senatit Akademik nr.10 , datë 05.02.2020 dhe Vendimin e Bordit të Administrimit nr.09, datë 07.02.2020 , për miratimin e hapjes së programeve të reja të studimit në ciklin e dytë "Master Profesional", "Master i Shkencave" dhe programeve me karakter profesional.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTOR

Prof. Dr Bektash MEMA





REPUBLIKA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

Nr. 220/2 prot

Gjirokastrë më 11. 02. 2020

PROJEKT PROPOZIMI PËR HAPJE PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni / IAL Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	2. Aplikimi Program i ri _____ X _____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje "Master Profesional në Shkencat Infermierore"	
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes Semestri i parë, viti akademik 2020 - 2021	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe /ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit <u>Licencimi i institucionit</u> VKM Nr.4, 08.01.1971 <u>Leja për fillimin e veprimtarisë</u> VKM, Nr.414, 12.11.1991 <u>Akreditimi i institucionit</u> Vendim i ASCAL Nr. 67, 21.09.2017 <u>Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore</u> Vendim/MASH Nr.128, 27.10.1994	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik Vendimi i miratimit nga Bordi i Administrimit <u>Vendimi i Senatit Akademik</u> Vendim nr. 10, datë 05.02.2020 <u>Vendimi i Bordit të Administrimit</u> Vendimi nr. 09, datë 07.02.2020
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL-së bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit. Nuk është program i përbashkët studimi me IAL të tjera	
8. Programi ofrohet nga/në : Departamenti i Infermierisë Fakulteti i Shkencave të Natyrës Kampusi / godina A	
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit: Emër Mbiemër Doc. Dr. Zamira Vllaho Pozicioni në IAL Përgjegjës i Njësisë Baze të Infermierisë Tel: 069 83 29 496 E-mail vllahozamira@yahoo.com	



10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standarteve akademike dhe infrastrukturore të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

DEKLARATË

“ PËR PLOTËSIMIN E STANDARTEVE AKADEMIKE DHE STANDARTEVE SHTETËRORE SIPAS AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE NË FUQI ”

Unë i nënshkruari **Prof.Dr Bektash MEMA**, Rektor i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se UGJ-ja, plotëson të gjitha standartet akademike dhe standartet shtetërore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore: ligjin e arsimit të lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 879 datë 18.12.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucione e Arsimit të Lartë”, udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 “Për dokumentacioni dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, si dhe statutin e UGj-së.


Universiteti “Eqrem Çabej” disponon burimet e duhura njerëzore si dhe strukturat përkatëse për realizimin e objektivave themelore të institucionit. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ mundësojnë realizimin cilësor të programeve mësimore që propozohen për miratim.

Çertifikimi i akreditimit me nr. 67 datë 21. 09. 2017 e vlefshme deri në 30. 09. 2020 është tregues i standarteve të cilësisë që plotëson Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

11. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit

Rektori i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër

Prof. Dr. Bektash MEMA



PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE

a) Të dhëna të përgjithshme mbi programin e studimit:

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

a. Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit mësimor

- Qëllimi i këtij programi është formimi i një figure profesionale fleksibël, e aftë për t'i ofruar me ndershmëri dhe profesionalizëm dijet dhe aftësitë e veta në menaxhimin infermieror të semumundjeve të ndryshme të popullatës.
- Planet e studimit orientuese do ta drejtojnë studentin për marrjen e kompetencave infermieristike që mund të shfrytëzohen nga po ai në ambientet spitalore, rurale apo urbane, në qendra terciare apo dhe në trajtime intensive të pacientëve që u ofrohet shërbimi shëndetësor publik apo dhe jo publik.

b. Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

Programi i studimit "Master Profesional në Shkencat Infermierore" ka qëllim të pajisë studentët me:

- Kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe promocionit shëndetësor, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional;
- Njohuri të mira në menaxhimin e shërbimit shëndetësor, të higjenës spitalore, trajtimit ambulator dhe hospitalor të pacientëve, përgatitjen operatore dhe ndjekjen post-operatore të tyre, njohjen me aparaturat mjekësore dhe mirëmbajtjen e tyre; në menaxhimin e urgjencat mjekësore në mjedisin hospitalor dhe jashtë tij.
- Aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, cprorëve, vartësve, pacienteve dhe familjarëve. Për përdorimin e metodave kerkimore-shkencore dhe telematike në fushat me kompetenca specifike.

b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifat dhe modalitetet financiare për studentët:

Për t'u pranuar në programin e studimit "Master Profesional në Shkencat Infermierore", kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve Bachelor të arsimit të lartë në RSH në njerin prej programeve të studimit Bachelor në Infermieri të përgjithshme; Bachelor në Mami. Kandidati mund të zotërojë edhe ndonjë dëftesë /diplomë të arsimit të lartë, të fituar në një institucion jashtë vendit, me kushtin që dokumentacioni të jetë i ekuivalentuar nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin ekzistues shqiptar.

Në rast se numri i kandidatëve do të jetë më i lartë se numri i parashikuar për t'u pranuar në këtë program studimi, atëherë kandidatët fitues do të renditen sipas notës mesatare të ciklit të parë të studimeve Bachelor.

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program

60 (gjashtë dhjetë)

Numri minimal i studentëve për hapjen e programit

10 (dhjetë)

Nr.	Master		Tarifa e shkollimit	Kostoja e shkollimit
1	profesional	Program i parë studimi	60.000 mijë lekë/vit/student	64.000 mijë lekë/vit/student
2		Program i dytë studimi	72000 mijë lekë/vit/student	76.400 mijë lekë/vit/student

Si burim financimi i këtij programi studimi do të shërbejë buxheti i universitetit dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga tarifat e shkollimit.



c) Plani mësimor / Kurrikulat e programit të studimit

Programit të studimit të ciklit të II: Master Profesional në Shkencat Infermierore

Viti akademik: 2020-2021

Forma e studimit: me kohë të plotë

Kohëzgjatja/ECTS total: 1 vit / 60 ECTS

Nr	Lëndët	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese							Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda						Semestri kur zhvillohet lënda
									Semestri I/15 javë (15 javë mesim)			Semestri II/15 javë (9 javë mesim & 6 javë praktike)			
		A-E	ECTS	Orë gjithsej në auditor	Leksione	Seminar	Praktike	Orë gjithsej jashtë auditorit	Leksione	Seminar	Praktike	Leksione	Seminar	Praktike	
Viti I															
1	Kërkimi shkencor ne infermieri	A	5	60	45	15		65	3	1					I
2	Menaxhimi I Urgjencave Pediatrike	B	5	60	45	15		65	3	1					I
3	Menaxhimi I Infeksioneve Nozokomiale	B	5	60	45	15		65	3	1					I
4	Teknikat Infermierore Bashkëkohore	B	10	120	75	45		130	5	3					I
5	Promocion & Organizim Shëndetësor	B	4	54	36	18		46				4	2		II
6	Menaxhimi I pacientit ne mjekesine interne.	C	6.5	63	45	18		99.5				5	2		II
7	Lënde me Zgjedhje: Menaxhimi I pacientit kirurgjikal Menaxhimi infermieror ne Toksikologji Klinike	C	6.5	63	45	18		99.5				5	2		II
8	Praktike Profesionale	D	6	150			150							25	II
9	Teza e Diplomes	E	12	30				270							II
Gjithsej			60	660	336	144	150	840							

PRAKTIKA

Semestri i Dytë (6 javë = 6 ECTS)

- | | | | |
|--------------------------|----------|--------|----------|
| 1. Pediatri | (50 ore) | 2 Javë | (2 ECTS) |
| 2. Kirurgji | (25 ore) | 1 Javë | (1 ECTS) |
| 3. Semundje të Brendshme | (50 ore) | 2 Javë | (2 ECTS) |
| 4. Urgjencë | (25 ore) | 1 Javë | (1 ECTS) |



d) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Personeli akademik (Emri Mbiemri)	Titulli / grada shkencore	Institucioni	Njesia Kryesore	Njesia Baze	Lloji i angazhimit (PAE / PAK)
Zamira Vllaho	Doc.Dr.	UGJ	FSHN	Infermierise	PAE
Laura Mezin	Dr.	UGJ	FSHN	Infermierise	PAE
Maria Agolli	Prof.Asoc	UGJ	FSHN	Infermierise	PAE
Bledar Late	Master Ekzekutiv	UGJ	FSHN	Infermierise	PAE
Altin Goxharaj	Specializim afatgjatë në mjekësi	UGJ	FSHN	Infermierise	PAK

e) Infrastruktura akademike në funksion të programit:

Infrastruktura në dispozicion të programit (Informacion lidhur me: auditoret labororet e duhur biblioteken mjetet kompjuterike sistemet IT etj.

Aktualisht Departamenti i Infermierisë ka ambjentet si më poshtë:

a. Auditorë

Departamenti i Infermierise ka 1 auditor me kapacitet rreth 100 vende dhe 3 auditorë për zhvillimin e orëve të seminareve me kapacitet 45 vende.

b. Laboratorë

Departamenti i Infermierise ka një Laborator të Infermieristikës. Ne dispozicion janë gjithashtu Laboratori i Biologjisë dhe Biokimisë të Departamentit Biologji-Kimi.

c. Biblioteka

Biblioteka e Universitetit është në dispozicion edhe të Departamentit të Infermierise.

d. Mjete kompjuterike

Janë në dispozicion të programit mesimor 20 mjete kompjuterike, printera dhe makina fotokopjimi. Të gjithë kompjuterat janë të lidhur me sistem të vazhdueshëm interneti.

f) Programet e përbashkët:

Nuk është program i përbashkët studimi me IAL të tjera



g) Analizë e tregut të punës :

Studentet që përfundojnë me sukses këtë program studimi mund të punësohen :

- Studenti me formim të tillë mund të punojë si infermier në institucione shtetërore shëndetësore në qendrat urbane dhe /ose rurale. Ky student është më i preferuar në qendrat e shërbimit spitalor të tilla si spitalet rajonale për përzgjedhjen specifike të personelit të punësuar këtu, ku këkohen njohuri më të thella mjekësore si dhe kompetencë profesionale.
- Studenti me formim të tillë mund të punojë në organizma dhe organizata ndërkombëtare, shoqata të huaja dhe vendase si operator dhe kurator i marrëdhënieve ndërkombëtare, mund të punojë në administratën publike etj;
- Studenti me formim të tillë mund të punojë, gjithashtu, infermier në qendrat e rehabilitimit psikomotor në grup mosha të ndryshme, në klinika private brenda dhe jashtë shtetit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 184 Prot.

Gjirokastrë, më 05.02.2020

V E N D I M

Nr. 10, datë 05.02.2020

**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA,
NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 14 pika 6 dhe pika 9, vendimit nr. 879 datë, 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë" Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 05. 02. 2020;


V E N D O S I :

1. Në zbatim të akteve të reja nënligjore, vendimit nr. 879, datë 18.12.2019 dhe udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të cilat përcaktojnë elementë të rinj për aplikim për programe të reja të studimit, senati akademik i UGj-së, miraton shfuqizimin e vendimit nr. 25, datë 08.11.2019, miratimi i hapjes së programit të dyfishtë të studimit në ciklin e dytë në bashkëpunim me Universitetin e Maçeratës – Itali, "Master i Shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC dhe shfuqizimin e vendimit nr. 03, datë 09. 01. 2020, miratimi e hapjes i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Financë – Kontabilitet.



2. Të miratojnë hapjen e programeve të reja të studimit si më poshtë:
- a. Programin e dyfishitë të studimit të universitetit "Eqrem Çabej" me universitetin e Maçeratës - Itali, në ciklin e dytë **"Master i Shkencave"** në **Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC**, i cili do të realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 ECTS në sistemin me kohë të plotë i cili do të ofrohet nga departamenti i Historisë dhe Gjeografisë në njësinë kryesore Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - b. Programin e studimit të ciklit të dytë **"Master i Shkencave"** në **Financë – Kontabilitet**, ofruar nga departamenti i Kontabilitet – Financës në njësinë kryesore Ekonomik, i cili do të realizohet me 120 ECTS në 2 (dy) vite akademike.
 - c. Programin e studimit të ciklit të dytë **"Master Profesional "** në **Shkencat Infermierore**, ofruar nga departamenti i Infermierisë në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 60 ECTS , në 1 (një) vit akademik.
 - d. Programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar **"Asistent - Menaxher në Mbrojtje Mjedisë"**, ofruar nga departamenti i Biologji – Kimi në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 120 ECTS, në 2 (dy) vite akademike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

V E N D I M

NR. 09, datë 07.02.2020

MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA
NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAI.-të në Republikën e Shqipërisë", neni 49, me vendimin nr. 10 të Senatit Akademik me nr. 184 Prot., datë 05. 02. 2020. Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 07. 02. 2020,

V E N D O S I :

1. Të miratojë shfuqizimin e **vendimit nr. 63, datë 14. 11.2019**, miratimi i hapjes së programit të dyfishtë të studimit në ciklin e dytë në bashkëpunim me Universitetin e Maçeratës – Itali, " Master i Shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC dhe shfuqizimin e vendimit **nr. 05, datë 10. 01. 2020**, miratimi e hapjes i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Financë – Kontabilitet;
2. Të miratojnë hapjen e programeve të reja të studimit si më poshtë:
 - A. Programin e dyfishtë të studimit të universitetit "Eqrem Çabej" me Universitetin e Maçeratës - Itali, në ciklin e dytë "**Master i Shkencave**" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC, i cili do të realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 ECTS në sistemin me kohë të plotë i cili do të ofrohet nga departamenti i Historisë dhe Gjeografisë në njësinë kryesore të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;



- B. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master i Shkencave”** në **Financë – Kontabilitet**, ofruar nga departamenti i Kontabilitet – Financës në njësinë kryesore Ekonomik, i cili do të realizohet me 120 ECTS në 2 (dy) vite akademike;
- C. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master Profesional ”** në **Shkencat Infermierore**, ofruar nga departamenti i Infermierisë në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 60 ECTS , në 1 (një) vit akademik;
- D. Programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar **“Asistent Menaxher në Mbrojtje Mjedisë ”**, ofruar nga departamenti i Biologji – Kimi në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 120 ECTS, në 2 (dy) vite akademike;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE – ADMINISTRATIVE
SEKTORI I STANDARTEVE DHE I KURRIKULAVE

Nr. 733 Prot.

Gjirokastrë, më 06/04 /2020

Lënda: Kthim përgjigje për mangësitë në dokumentacionin për programin e ri të studimit në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" në Shkencat Infermierore .

ZNJ. BESA SHAHINI
MINISTRE
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

Në vijim të njoftimit Tuaj zyrtar të ardhur në adresën zyrtare të universitetit "Eqrem Çabej" në datën 23.06.2020 "Njoftim për mangësitë e konstatuara nga ekspertët", pasi u konstatuam me mangësitë e ekspertëve të cilët shqyrtojnë dokumentacionin e aplikimit për programin e ciklit të dytë "Master Profesional" në Shkencat Infermierore, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 1 datë 14.02.2020, Kreu IV, pika 7/b, ju bëjme me dije si mëposhtë:

Rekomandimi i parë i ekspertëve.

Aftësitë dhe kompetencat profesionale kërkojnë jo vetëm program të konsoliduar teorik por edhe praktika infermierore , në formë të praktikave lëndore të cilat duhet të realizohen në laboratorët e infermieristikës pranë institucionit ashtu edhe praktikat profesionale të cilat realizohen në institucionet shëndetësore. Nuk ka të dhëna mbi marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit apo aktorë të biznesit vendas apo të huaj.

Ju bëjmë me dije se, në zbatim të udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 , Kreu IV, në të gjitha pikat e këtij kreu dhe në të dyja fazat e kaluara, nuk është kërkuar " Marrëveshje me institucione të tjera ..." si dokument më



vete. Por ndërkohë në formatin e kërkesës zyrtare të dërguar në fazën e parë, është cituar, marrëveshja që universiteti jonë ka me Spitalin Rajonal “ Omer Nishani ” në Gjirokastrë.

Rekomandimi i dytë i ekspertëve

Në programin e paraqitur nuk ka orë mësimore të praktikave laboratorike ose lëndore

Në zbatim të këtij rekomandimi, përgjegjësia e njësisë bazë riorganizoi planin mësimor ku një pjesë të seminareve do ti kalojë si praktika laboratorike në masën (50 %), përkatësisht në planin mësimor për lëndët “Menaxhimi i urgjencave pediatrike”, “Menaxhimi i pacientit në mjekësinë interne”, “Menaxhimi i pacientit kirurgjikal”, “Menaxhim i pacientëve në obstetrikë-gjinekologji” dhe “Teknika infermiere bashkëkohore” janë planifikuar të zhvillohen praktika laboratorike.

Rekomandimi i tretë i ekspertëve

Nuk plotëson standartet akademike pasi vetëm një titullar lënde (nga 5) është i kategorisë Profesor dhe vetëm 3 (nga 5) kanë gradën Doktor.

Në zbatim të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, Njësia Bazë e Infermierisë ka 8 anëtarë personel akademik. Nga të cilët 1(një) është me gradën shkencore “Prof.asoc”, 3 janë “Asistent Lektor”, 3 (tre) janë me gradën shkencore “Doktor ” 1(një) është me gradën “Master Ekzekutiv” dhe 1(një) me Specializim afatgjatë në Mjekësi , tituj të cilat: Në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ”, përkatësisht neni 77 “ Programet e ciklit të tretë të studimeve ” pika 1 . Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master Ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoraturës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Për rrjedhojë personeli akademik i cili do të zhvillojë këto lëndë .

- a. **Master Ekzekutiv Bledar Late**, ka kualifikimin sipas përcaktimeve të nenit 77 pika 2 , “Programet e studimeve “Master Ekzekutiv” ofrojnë arsimin e një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen në një ose dy vite akademike dhe organizohen me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim lëshohet diploma “Master Ekzekutiv” në fushën e arsimit të kryer” .
- b. **Specializim afatgjatë në mjekësi Altin Goxharaj**, ka kualifikimin sipas përcaktimeve të nenit 77 pika 3, “Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe



organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbillen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi " në fushën përkatëse të programit të studimit". Pra gjithësej janë 5 personel akademik me gradën "Doktor"

Rekomandimi i katërt i ekspertëve

Ka mangësi në planin mësimor dhe programin e studimit në raport me praktikën laboratorike lëndore

Siç u përmend edhe në rekomandimin më lart, ky plan mësimor u riorganizua duke parashikuar një pjesë të seminareve në praktika laboratorike.

Rekomandimi i pestë dhe i gjashtë i ekspertëve

Nuk ka lëndë të Infermieristikës në Obstetrikë – Gjinekologji dhe Lënda menaxhim kirurgjikal të pacientit, lëndë e një rëndësie të veçantë, është klasifikuar si lëndë me zgjedhje dhe e veprimtarisë formuese C, klasifikimi në këtë kategori dhe si lëndë me zgjedhje nuk përputhet me objektivat e programit të studimit të cilesuara nga vetë IAL.

Plani mësimor për këtë program studimi u riorganizuar duke përfshirë këto rekomandime, në përputhje me vendimin nr.41, dt.24.01.2018 dhe Vendimit nr.879, dt.18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, dt.24.01.2018 të Këshillit të Ministrave. "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe u miratuan nga të gjitha strukturat e universitetit tonë. Në planin mësimor, është vendosur lënda "Menaxhim i pacientëve në obstetrikë-gjinekologji" dhe lënda "Menaxhim kirurgjikal i pacientit" të cilat klasifikohen si lëndë karakterizuese B.

Një kopje e planit të riorganizuar do të dërgohet bashkangjitur shkresës me argumentimet përkatëse.

Rekomandimi i shtatë i ekspertëve

Në dokumentacion mungon informacioni për përbërjen dhe kualifikimin e anëtarëve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do tju përcillet informacioni i plotë për të gjithë anëtarët personel akademik i Njësisë Kryesore FSHN dhe gjithashtu për njësinë bazë përgjegjëse që do të ofrojë këtë program studimi.



Rekomandimi i tetë i ekspertëve

Institucioni deklaron ekzistencën e vetëm një laborator i infermieristike , i cili është i pamjaftueshëm për numrin e lartë të studentëve të pritshëm dhe ata ekzistues duke mos plotësuar kështu standartet infrastrukturale për realizimin dhe ofrimin e programit të studimit.

Në kërkesën tonë për hapjen e këtij programi studimi kemi deklaruar të gjithë kapacitetet infrastrukturale të nevojshme që disponon universiteti jonë për këtë program studimi. Ndërkohë, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 324 prot, datë 05. 03. 2020 , lidhur me Spitalin Rajonal “Omer Nishani”, neni 4 “Detyrimet e palëve”, nga ana e institucionit shëndetësor na vihen në dispozicion të njësisë bazë të infermierisë ambientet klinike, laboratorët në të gjitha specialitetet strukturale ,diagnostikuese , kurative në të gjitha repartet për zhvillimin e të praktikave profesionale dhe laboratorike të cilat do të jenë brenda standarteve infrastrukturale për realizimin e këtij programi studimi. Gjithashtu universiteti jonë është në fazën parë për zgjerimin e infrastrukturës për ngritjen e një laborator të dytë për programet e Infermierisë.

Një kopje e kësaj marrëveshjeje do të bashkëlidhet me të gjithë dokumentacionin që do t’ju dërgohet.

Rekomandimi i nëntë i ekspertëve

Institucioni nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Shëndetësore për realizimin e praktikës profesionale.

Universiteti “Eqrem Çabej” , ka pasur gjithmonë marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Shëndetësore në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale që studentët e programeve “Bachelor” në Infermieri dhe Infermieri Mami kanë zhvilluar praktikën, të dokumentuara këto ndër vite . Një kopje të këtyre marrëveshjeve do t’ju përcillet zyrtarisht.

Rekomandimi i dhjetë i ekspertëve

IAL-ja nuk ofron infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e këtij programi studimi:

- Kapacitete laboratorike të pamjaftueshme
- Nuk ka të detajuar marrëveshjet për kryerjen e praktikës profesionale, një komponent i rëndësishëm i programit mësimor.

Për të dyja këto rekomandime kemi dhënë argumentimin tonë në pikat e sipercituara më lart.



Rekomandimi i njëmbëdhjetë i ekspertëve

Ka mangësi dhe probleme në dokumentacionin si psh:

- Syllabuset e lëndëve nuk janë të plota (mungojnë syllabuset për modulet “Kërkim shkencor në Infermieri” dhe Menaxhim i Infeksioneve Nozokomiale dhe Promocion & Organizim Shëndetësor).
- Formati i syllabuseve nuk plotëson kriteret e VKM –sc nr. 41 të MASR.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, syllabuset e gjithë lëndëve janë formatuar në përputhje me VKM nr. 41, dt.24. 01 .2018 dhe vendimit nr.879, dt.18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, dt.24.01.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, duke reflektuar edhe ndryshimet në lidhje me praktikën laboratorike përkatëse të sipërpërmendura.

Rekomandimi i dymbëdhjetë i ekspertëve

Kriteret e regjistrimit në rregullore ka në paqartësi/pasaktësi në raport me studentët që mund të aplikojnë në këtë cikël studimi: masteri profesional në shkencat infermiore është dhe duhet të jetë i dedikuar për studentë të diplomuar për ciklin e parë “Bachelor” në Shkencat Infermiore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, në rregulloren e programit të studimit është qartësuar fakti se ky program studimi është i dedikuar për studentë të diplomuar në Bachelor në Shkencat Infermiore.

I gjithë dokumentacioni shoqëruar lidhur me këto rekomandime do të dërgohet në mënyrë elektronike në adresën zyrtare aplikime.ial@arsimi.gov.al dhe në mënyrë shkresore pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Prof.dr Bektash MEMA
REKTOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 707 Prot.

Gjirokastër, më 03.07.2020

V E N D I M

Nr. 24, datë 03.07.2020

P Ë R
MIRATIMI I NDRYSHIMEVE NË DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT PËR
PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" NË SHKENCAT
INFERMIERORE

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 72, Vendimit nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të"; udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 20 pika 3, vendimit të njësisë bazë, nr. 24, dt 30.06.2020, vendimit të njësisë kryesore FSHN nr. 4, datë 01.07.2020 dhe në përgjigje të emailit zyrtar të MASR-së të datës 26.06.2020 me subjekt : "Njoftim mbi mangësitë e konstatuara nga ekspertët", protokolluar në universitetin "Eqrem Çabej" me nr. 656 prot, datë 24.06.2020, Senati Akademik diskutoi rreth këtyre mangësive / rekomandimeve të ekspertëve dhe propozimeve të ardhura nga Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë mbi ndryshimet në dosjen e aplikimit për këtë program studimi dhe në mbledhjen e tij të datës, 03. 07. 2020;

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimet në dokumentacionin e aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në Shkencat Infermierore sipas materialit drejtuar Senatit Akademik bashkelidhur këtij vendimi.



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i përcillet strukturave përkatëse.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEL"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 728 Prot.

V E N D I M

NR. 30, datë 06. 07.2020

MIRATIMI I RIALOKIMIT TË FONDEVE NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË
PROKURIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2020

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë" neni 49, si dhe bazuar në shkresën e Administratorit me Nr. 717 prot., datë 03.07.2020, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 06.07.2020.

V E N D O S I:

1. Të miratojë rialokimin e fondeve dhe shtimin e zërit në vlerën prej 8.583.872 lekë për blerjen e pajisjeve për laboratorin e Infermierisë Nr.2;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR

Dr. Merita SARAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr 248 Prot.

Gjirokastrë, më 01.07.2020

VENDIM

NR. 4 DATË 01 / 07 / 2020

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE
NË DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT PËR PROGRAMIN TË STUDIMIT:
"MASTER PROFESIONAL NË SHKENCAT INFERMIERORE"

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 72; VKM nr.879 dt.18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41 dt.24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të"; Udhëzimit të MASR nr.1, datë 14.01.2020 të MASR për "Dokumentacionin dhe procedurat përhapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 20 pika 3; Vendimit të Njesisë Bazë të Infermierisë nr.24 dt.30.06.2020; në përgjigje të e-mailit zyrtar të datës 23.06.2020 me subjekt: "Njoftim mbi mangësitë e konstatuara nga ekspertët", protokolluar në Universitetin tonë me nr. 656 prot, datë 24.06.2020,

Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në mbledhjen e tij të datës 01.07.2020 diskutoi rreth propozimit të Departamentit të Infermierisë mbi ndryshimet në dosjen e aplikimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Shkencat infermierore" përshtatur në përgjigje të shkresës me vërejtjet e ekspertëve.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur i cili ishte në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar, Dekanati me votim unanim:

VENDOSI

1. Në zbatim të Vendimit nr.879, dt.18.12.2019 dhe Udhëzimit nr.1, dt. 14.01.2020, të cilat përcaktojnë elementët për aplikim për programe të reja studimi, të shfuqizohet Vendimi nr.3, dt. 03.02.2020 i Dekanatit të FSHN-së.
2. Të miratojë ndryshimet në dokumentacionin e aplikimit për hapjen e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Shkencat infermierore".
3. T'i propozojë Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" miratimin e ndryshimeve në dosjen e aplikimit për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Shkencat Infermierore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dekan
Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Nr.24 Prot.

Gjirokaster, me 30.06.2020

VENDIM

Departamenti i Infermierise i Fakultetit te Shkencave te Natyres ne Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokaster, ne mbledhjen e dates 30.06.2020, miratoi ndryshimet ne dokumentacionin e aplikimit për programin e studimeve të Ciklit te Dyte Master Profesional ne "Shkencat Infermierore", në përgjigje të e-mailit zyrtar të datës 23.06.2020 me subjekt: "Njoftim mbi mangësitë e konstatuara nga ekspertët", protokolluar në Universitetin tonë me nr. 656 prot, datë 24.06.2020, te pergatitur sipas kriterave te dhena ne Udhëzimin nr.1, dt.14.01.2020 te MASR, "Per dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit te Arsimit te Larte, degeve te tyre, njesive kryesore dhe programeve te studimit, si dhe per ndarjen ose bashkimin e Institucionit te Arsimit te Larte" dhe vendimit nr.879, dt.18.12.2019, per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.41, dt.24.01.2018 te Keshillit te Ministrave. "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga Institucionet e Arsimit te Larte".

Ndryshimet e miratuara:

- Në përgjigje të vërejtjes nr. 2, në planin mësimor, në lëndët "Menaxhimi i urgjencave pediatrike", "Menaxhimi i pacientit në mjekësinë interne", "Menaxhimi i pacientit kirurgjikal". "Menaxhim i pacientëve në obstetrikë-gjinekologji" dhe "Teknika infermierore bashkëkohore" janë planifikuar të zhvillohen praktika laboratorike.
- Në përgjigje të vërejtjes nr. 3, në planin mësimor, është vendosur lënda "Menaxhim i pacientëve në obstetrikë-gjinekologji" e cila klasifikohet si lëndë karakterizuese B.
- Në përgjigje të vërejtjes nr. 4, lënda "Menaxhim kirurgjikal i pacientit" klasifikohet si lëndë karakterizuese B.
- Në përgjigje të vërejtjes nr. 9b, syllabuset e gjithë lëndëve janë formatuar në përputhje me VKM nr.879, dt.18.12.2019, duke reflektuar edhe ndryshimet në lidhje me praktikat laboratorike përkatëse të sipërpërmendura.
- Në përgjigje të vërejtjes nr. 9c, në rregulloren e programit të studimit është qartësuar fakti se ky program studimi është i dedikuar për studentë të diplomuar në Bachelor në Shkenca Infermierore.

PËRGJEGJESE E NJESISË BAZË

Doc. Dr. Zamir Vllaho





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Selfo ORUÇI

REKTORI

Prof. Dr. Bekdash MEMA



Përgjegjësi i Njesisë Bazë

Doc. Dr. Lamira VLLAHO

**PLAN MËSIMOR I
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
Master Profesional në Shkencat Infermierore**

Forma e studimit: *Me kohë të plotë*
Viti Akademik: 2020-2021
Kohëzgjatja/ECTS total: 1 vit/60 ECTS



Nr	 Lëndët	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese							Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda								zhvillohet		
									Semestri I/15 javë (15 jave mesim)				Semestri II/15 javë (9 jave mesim & 6 jave praktike)						
		A-E	ECTS	Orë gjithsej në auditor	Leksione	Seminar	Laboratore	Praktike	Orë gjithsej jashtë auditorit	Leksione	Seminar	Laboratore	Praktike	Leksione	Seminar	Laboratore		Praktike	
Viti I																			
1	Menaxhimi i Infeksioneve Nozokomiale	A	5	60	45	15			65	3	1							I	
2	Menaxhimi i Urgjencave Pediatrike	B	5	60	45	8	7		65	3	0.5	0.5						I	
3	Menaxhimi i pacientit ne mjekesine interne	B	5	60	45	8	7		65	3	0.5	0.5						I	
4	Menaxhimi i pacientit kirurgjikal	B	7	74	54	11	9		101					6	1.25	1		II	
5	Menaxhimi i pacienteve ne Obstetrike-Gjinekologji	B	5	59	45	9	5		66					5	1	0.5		II	
6	Teknikat Infermierore Bashkekohore	C	10	120	75	30	15		130	5	2	1						I	
7	Lende me zgjedhje: a.Promocion & Organizim shendetesor b.Menaxhimi infermieror ne toksikologji klinike c.Kerkimi shkencor ne Infermieri	C	5	59	45	14			66					5	1.5			II	
8	Praktike Profesionale	D	6	150				150									25	II	
9	Teza e Diplomes	E	12						300									II	
Gjithsej				60	642	354	95	43	150	858									

PRAKTIKA

Semestri i Dytë (6 jave = 6 ECTS)

1. Pediatri	(25 ore)	1 Jave	(1 ECTS)
2. Semundje te Brendshme	(50 ore)	2 Jave	(2 ECTS)
3. Kirurgji	(25 ore)	1 Jave	(1 ECTS)
4. Obstetrike-Gjinekologji	(25 ore)	1 Jave	(1 ECTS)
5. Urgjence	(25 ore)	1 Jave	(1 ECTS)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
NJËSIA BAZE E INFERMIERISË

Nr. 26 Prot.

Gjirokastër, më 30.06.2020

Lista emerore e personelit akademik që do të angazhohet në programin e ciklin të dytë të studimeve, "Master Profesional në Shkencat Infermierore"

Personeli akademik (emër mbiemër)	Titulli/Grada shkencore	Institucioni	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lloji i angazhimit (PAE/PAK)	Ngarkesa mesimore
Zamira Vllaho	Doc. Dr	UGJ	FSHN	Infermieri	PAE	156 orë
Laura Mezini	Dr	UGJ	FSHN	Infermieri	PAE	158 orë
Maria Agolli	Prof.asoc	UGJ	FSHN	Infermieri	PAE	59 orë
Bledar Late	Master Ekzekutiv	UGJ	FSHN	Infermieri	PAE	217 orë
Altin Goxharaj	Specializim afatgjatë në mjekësi	UGJ	FSHN	Infermieri	PAK	170 orë

Përgjegjëse e njësisë bazë

Doc.Dr. Zamira VLLAHO

DEKAN

Prof.asoc Selfo ORUÇI



LISTA E PERSONELIT AKADEMIK
Institucioni : Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokaster

Nr.	Emër Mblemër	Kategoria	Titulli/Grada	Statusi i punësimit (PAE/PAK)
FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES				
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES, INFORMATIKES DHE FIZIKES				
1	Dhori Terpo	Lektor	Dr	PAE
2	Jani Dine	Profesor	Prof.asoc	PAK
3	Arben Isufati	Lektor	Doc/Dr	PAE
4	Romeo Mano	Lektor	Doc/Dr	PAE
5	Jani Lica	Lektor	Doc/Msc	PAE
6	Roland Vasili	Asistent Lektor	Msc	PAE
7	Krisanthi Naka	Lektor	Dr	PAE
8	Kostaq Lili	Asistent Lektor	Msc	PAE
9	Inva Bilo	Asistent Lektor	Msc	PAE
10	Kastriot Zoto	Lektor	Dr	PAE
11	Isidor Kokalari	Lektor	Doc/Dr	PAE
12	Antuela Sinani	Lektor	Dr	PAE
13	Besian Rama	Asistent Lektor	Msc	PAK
14	Idajet Selmani	Asistent Lektor	Msc	PAK
DEPARTAMENTI I BIOLOGJIS KIMISE				
1	Sadik Malo	Profesor	Prof.asoc	PAE
2	Selfo Oruci	Profesor	Prof.asoc	PAE
3	Lavdi Hasani	Profesor	Prof.dr	PAE
4	Majlinda Terpo	Profesore	Prof.asoc	PAE
5	Gligor Paspali	Profesore	Prof.asoc	PAE
6	Etleva Hysaj	Lektor	Dr	PAE
7	Anduela Qendro	Lektor	Dr	PAE
8	Aneta Çomo	Asistent Lektor	Msc	PAE
DEPARTAMENTI I INFERMIERISE				
1	Zamira Vllaho	Lektor	Doc/Dr	PAE
2	Maria Agolli	Profesore	Prof.asoc	PAE
3	Laura Mezini	Lektor	Dr	PAE
4	Arjeta Xhemali	Asistent Lektor	Msc	PAE
5	Dritan Rami	Asistent Lektor	Msc	PAE
6	Xhenisa Graci	Asistent Lektor	Msc	PAE
7	Bledar Late	Lektor	Master Ekzekutiv	PAE
8	Altin Goxharaj	Lektor	Specializim afatgjate ne mjekesi	PAK



21.05.2020
Nr. 164 Prot
EHO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 324...prot

Gjirokastrë, më 06.03.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 06.03. 2020 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga Rektori, Prof.dr Bektash MEMA dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof. Asoc. Selfo ORUÇI.

dhe

Drejtoria e Spitalit Raional "Omer Nishani" Gjirokastrë, përfaqësuar nga Drejtori, z Sokol FERUNI

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Ligjin Nr. 10107, datë 30.03. 2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2
Qëllimi i marrëveshjes

Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.

Neni 3
Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 06.03.2020 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Neni 4
Detyrimet e palëve

Njësia Bazë e Infermierisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor në Spitalin Rajonal Gjirokastrë. Spitali Rajonal Gjirokastrë është institucion publik i ofrimit të kujdesit shëndetësor të specializuar, i cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Infermierisë, ambjentet klinike, laboratorët në të gjitha specialitetet strukturale, diagnostikuese, kurative në të gjitha repartet, si Shërbimin e Patologjisë, Shërbimin e Kirurgjisë, Shërbimin e Obstetrike-Gjinekologjisë, Shërbimin e Pediatrisë, Shërbimin e Urologjisë, Shërbimin Diagnostikues Imazhorik, Shërbimin e Ambulancës Qendrore, Shërbimin e Sëmundjeve Infektive pa pagesë.

Neni 5



Neni 5

Njësia Bazë e Infermierisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve të saj në specialitete të ndryshme, në bashkëpunim me strukturat e kujdesit spitalor.

Neni 6

Njësia Bazë e Infermierisë shërben si burim i njohurive më të fundit në fushën e diagnostikimit dhe terapisë të sëmundjeve torakale, abdominale, vaskulare, endoskopisë digjestive, kirurgjikale, obstetrikale, pediatrike nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me partnerë europiane dhe specialistët e Spitalit Rajonal Gjirokastrë

Neni 7

Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Spitalin Rajonal Gjirokastrë ofron për komunitetin diagnostikimin dhe terapiën intervenuese në fushën e sëmundjeve torako-abdominale, kirurgjikale dhe vaskulare.

Neni 8

Universiteti "Eqrem Çabej Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Njësia Bazë e Infermierisë dhe Spitali Rajonal Gjirokastrë krijojnë mundësinë për punë kërkimore shkencore të pavarur të personelit dhe studentëve duke vënë në dispozicion kapacitete me teknologji të avancuara.

Neni 9

Njësia Bazë e Infermierisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me Klinikat, Universitetet e huaja dhe Spitalin Rajonal Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e Konferencave Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e specialistëve në fusha të ndryshme të mjekësisë.

Neni 10

Duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologët e vet europianë, Njësia Bazë e Infermierisë, si pjesë e këtij Universiteti, realizon kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata të pedagogëve, mjekëve, infermierëve, studentëve si dhe praktikantë profesionale.

Neni 11

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Bazë e Infermierisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet ngritjes së Sistemit të Edukimit Mjekësor të Vazhdueshëm dhe testimit për të gjitha kategoritë e personelit në mjekësi.

Neni 12

Marrëdhëniet financiare të personelit akademik mjek, infermier dhe ndihmës mësimor të Njësive Bazë të Infermierisë rregullohen me aktet ligjore në fuqi



Kjo marrëveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.

Për Universitetin "Eqrem Cabej"
Prof.dr Bektash Mema

REKTOR



Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Prof Asoc, Selfo Oruçi

DEKAN



Për spitalin Rajonal "Omer Nishani"

Sokol Feruni

DIREKTOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 235 Prot.

Gjirokastrë, më 06.03.2017

MARREVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 06.03.2017 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Cabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga *Rrektori, Prof.Dr Bektash MEMA*
dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, *Prof.Asoc.Dr Selfo ORUÇI*.

dhe

Drejtoria e Spitalit Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastrë, përfaqësuar nga Drejtori, z.
Krenar Kulla

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Qëllimi i marrëveshjes

Neni 2

Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.



Neni 3

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 06.03.2017 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjecare.

Detyrimet e palëve

Neni 4

Njësia Bazë e Infermierisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.

Spitali Rajonal Gjirokastrë është institucion publik i ofrimit të kujdesit shëndetësor të specializuar, i cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Infermierisë, ambjentet klinike, laboratorët në të gjitha specialitetet strukturale, diagnostikuese, kurative në të gjitha repartet, si Shërbimin e Patologjisë, Shërbimin e Kirurgjisë, Shërbimin e Obstetrikë-Gjinekologjisë, Shërbimin e Pediatriisë, Shërbimin e Urgjencës, Shërbimin Diagnostikues Imazherik, Shërbimin e Ambulancës Qëndrore, Shërbimin e Sëmundjeve Infektive pa pagese.

Neni 5

Njësia Bazë e Infermierisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve të saj në specialitete të ndryshme, në bashkëpunim me strukturat e kujdesit spitalor.

Neni 6

